Instituti Demokraci për Zhvillim
| Seria: Zgjedhjet dhe Partitë Politike | Nr. 14 | Prishtinë, 2020 |

Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje

Çfarë është vendosur për ankesat, apelet dhe lëndët penale të zgjedhjeve

Edicioni i dytë

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje

Çfarë është vendosur për ankesat, apelet dhe lëndët penale të zgjedhjeve

Prishtinë, shtator 2020

E drejta e autorit © 2020. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret serish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera, pa lejen paraprake të D4D-së.

Punim i përgatitur:

Dardan Berisha

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) me mbështetje të popullit amerikan përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES), si dhe nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme (FDFA). Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet pasqyrim i qëndrimit të donatorëve të lartcekur.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 7
Hyrje 10
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa 11
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 23
Prokuroria Shtetërore 28
Policia e Kosovës 32
Këshilli Gjyqësor i Kosovës 34
Komisioni i Pavarur për Media 46
Konkluzionet dhe rekomandimet 49
Lista e publikimeve 52

Tabela e figurave

Figura 1: Numri i ankesave dhe apeleve në zgjedhje, prej 2009 deri 2019 12

Figura 2: Numri i ankesave dhe apeleve, sipas fazave të procesit zgjedhor 14

Figura 3: Gjobat e PZAP-së për subjektet politike..... 15

Figura 4: Gjobat e PZAP-së, sipas subjekteve politike 16

Figura 5: Numri i ankesave sipas komunave ku ka ndodhur shkelja e supozuar (të hijezuara, top 10 për secilën zgjedhje) 18

Figura 6: Kush ankohet më shumë 19

Figura 7: Numri i vendimeve të PZAP, sipas llojeve të vendimeve 21

Figura 8: Numri i vendimeve të PZAP-së të apeluara në Gjykatën Supreme, sipas llojit të vendimit të Gjykatës 21

Figura 9: Shqyrtimi i aplikacioneve për Votim nga Jashtë nga KQZ 24

Figura 10: Përsëritjet e zgjedhjeve dhe rinumërimi në zgjedhjet prej 2009 deri 2019 26

Figura 11: Gjobat e KQZ për subjektet që kanë vonuar dorëzimin e raporteve financiare të fushatës 27

Figura 12: Numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë, nga viti 2013 deri në Shtator 2019 28

Figura 13: Numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë, nga viti 2013 deri në Shtator 2019. 29

Figura 14: Numri i kallëzimeve penale të dorëzuara në vitin 2013 dhe 2019, sipas parashtruesve 31

Figura 15: Përmbledhje e lëndëve të PK dhe personave të

arrestuar, gjatë zgjedhjeve 2013 dhe 2014 dhe 2019.....33

Figura 16: Numri i lëndëve dhe personave të involvuar në Gjykata për vepra penale kundër të drejtave të votimit 34

Figura 17: Numri i lëndëve në Gjykata, sipas veprave penale kundër të drejtave të votimit 35

Figura 18: Numri i lëndëve në Gjykata dhe personave të involvuar dhe llojit të aktgjykimeve.....37

Figura 19: Pasqyra vjetore e lëndëve të zgjidhura, sipas Gjykatave Themelore 44

Figura 20: Numri i rasteve në KPM kundër mediave audiovizuele, sipas natyrës së shkeljes 46

Figura 21: Numri i rasteve sipas subjekteve parashtruese, në zgjedhjet prej 2009 deri 2019.....47

Figura 22: Masat ndëshkimore të KPM-së, sipas mediave. 48

Përmbledhje ekzekutive

Janë disa akterë të involvuar në zgjidhjën e mosmarrëveshjeve zgjedhore në Kosovë. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është trup i pavarur i përbërë nga gjyqtarë të mandatuar të gjykojnë ankesat dhe parashtresat të lidhura me procesin zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për adiministrimin e zgjedhjeve, duke përfshirë regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve si dhe marrjen e raporteve financiare vjetore dhe të kampanjës. Krimet elektorale të cilat parashihen me kodin penal hetohen, ndiqen penalisht dhe gjykohen nga Policia e Kosovës (PK), Prokuroria e Shtetit (PSH), dhe gjykatat. Së fundi Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për monitorim dhe zbatimin e rregulloreve ti cilat kanë të bëjnë me media.

Përvojat nga zgjedhjet e kaluara kanë treguar se sinergjia mes këtyre akterëve është thelbësore për zgjidhjen efektive dhe të drejtë të mosmarrëveshjeve gjatë zgjedhjeve. Gjatë viteve koordinimi ndërmjet institutioneve për menaxhimin e zgjedhjeve dhe institucioneve të drejtësisë, ndëshkimi i subjekteve politike për shkeljet e rregullave të zgjedhjeve dhe ndjekja penale e personave që kanë shkelur të drejtat e votimit, kanë përmirësuar procesin zgjedhor ndër vite dhe kanë ngritur besueshmërinë e qytetarëve dhe subjekteve politike ndaj procesit.

Gjatë zgjedhjeve të mbajtura prej vitit 2009 deri 2019, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka pranuar mesatarisht 650 ankesa për një process zgjedhor. Numri i ankesave të dorëzuara në PZAP ka dalluar prej më së paku 326 ankesa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 deri më së shumti në 1,117 në zgjedhjet lokale të vitit 2017. Në zgjedhjet në nivel vendi të mbajtura gjatë kësaj dekade, vlera e përgjithshme e gjobave të shqiptuara nga PZAP ndaj subjekteve politike ka qenë EUR 1,831,120. Partia Demokratike e Kosovës ka qenë subjekti politik me ndëshkueshmërinë më të lartë, ndjekur

nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Për sa i përket mjeteve juridike të parashikuara përveç gjobave, të dhënat nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tregojnë se përsëritja e zgjedhjeve është duke u bërë praktikë më e pazakonshme, ndërsa rinumërimi i vendvotimeve praktikë më e zakonshme. Nuk ka pas asnjë përsëritje të zgjedhjeve në tri pale zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014, 2017 dhe 2019. Në zgjedhjet e fundit lokale 2017 dhe zgjedhjet parlamentare 2019, është shënuar ngritje e konsiderueshme e vendvotimeve të rinumëruara, të cilat rezultuan nga të dyja gjykimet e KQZ-së dhe PZAP-së.

Në Prokurorinë e Shtetit, numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit ka rënë në mënyrë drastike. Në vitin 2013, kishte 209 kallëzime penale që përfshinin 1,216 persona, ndërsa deri në Shtator të vitit 2019, Prokuroria e Shtetit i ka pas në punë vetëm 69 kallëzime penale që përfshijnë 109 persona. Shumica e kallëzimeve penale paraqiten nga Policia e Kosovës.

Gjykatat kanë pas numër të konsiderueshëm të lëndëve për veprat penale kundër të drejtave të votimit. Numri i lëndëve në Gjykata ka rënë nga 413 lëndë në vitin 2015 në 226 në vitin 2018, dhe më tej në 130 lëndë deri në Qershor të vitit 2019. Gjithashtu, numri i personave të përfshirë në këto lëndë ka rënë nga 1,172 në vitin 2014 në 501 në vitin 2018, dhe 273 deri në Qershor 2019. Nëntë nga dhjetë lëndët e zgjedhjeve kanë të bëjnë me veprën penale "Keqpërdorimi i të drejtës së votimit", që mbulon situatat kur personat kryejnë një apo më shumë nga shkeljet në vijim: a) voton apo tenton të votojë në emër të personit tjerër; b) voton apo tenton të votojë edhe pasi ka votuar një herë, dhe; c) shfrytëzon më shumë se një listë votimi.

Prej vitit 2015 deri në Qershor të vitit 2019, në 73% të lëndëve të zgjidhura, Gjykatat kanë vendosur me aktgjykim fajësues. Vetëm në 4% të rasteve ka pas aktgjykim lirues, ndërsa pjesa tjetër janë refuzuar ose zgjidhur me aktgjykim tjetër. Prej

lëndëve të zgjidhura me aktgjykim fajësues, të dhënat nga Gjykatat prej vitit 2015 deri në Qershor të vitit 2019 tregojnë se Gjykatat:

- në 9 raste kanë dënuar 11 persona me burg efektiv.
- në 31 raste kanë dënuar 37 persona me gjobë.
- në 278 raste (62%) kanë dënuar 699 persona me dënim me kusht. Në shumicën e rasteve të të denuarve me kusht, i denuari nuk është sanksionuar me burgim, mirëpo vetëm që do të burgoset nëse i denuari kryen ndonjë krim për një periudhë specifike (p.sh. brenda dy viteve)

Në Komisionin e Pavarur të Mediave, mos-dorëzimi ditarit të transmetimeve, dështimi për transmetim pa pagesë, shkelja e heshtjes zgjedhore, dhe gjuha e urrejtjes apo prezenca e fëmijëve në spot kanë qenë shkeljet më të zakonshme nga mediat. Në disa raste në zgjedhjet e mbajtura gjat 2017 dhe 2019, Komisioni i Pavarur i Mediave ka vendosur masa ndëshkimore ndaj mediave, kryesisht vërejtje dhe gjoba.

Hyrje

Edicioni i parë i raportit "Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje" është publikuar në vitin 2015 dhe ka prezantuar të dhëna për zgjedhjet e mbajtura prej vitit 2009 deri 2014. Ky është edicioni i dytë i raportit që bashkon të dhënat nga raporti i kaluar me të dhënat nga zgjedhjet e fundit lokale dhe parlamentare të vitit 2017 dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2019.

Të dhënat që prezantohen në këtë raport në mes tjerash janë: numri i ankesave dhe apeleve të dorëzuara në PZAP, llojet e vendimeve dhe gjobat e shqiptuara për subjektet politike nga PZAP, numri i lëndëve të veprave penale që ndërlidhen me votimin dhe masat sanksionuese të marra nga Gjykatat, numri i komunave apo vendvotimeve ku ka pasur rivotim, numri i vendvotimeve të rinumëruara, dhe veprimet e ndërmarra për ankesat ndaj mediave. Në rastet kur ka pasur informata të detajuara, të dhënat janë ndarë sipas natyrës së shkeljes, viteve, llojit të vendimit apo aktgjykimit, komunës dhe rajonit.

Për të përgatitur edicionin e dytë të raportit, D4D ka mbledhur të dhëna nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Policia e Kosovës (PK), Prokuroria Shtetërore (PSH), dhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM).

Përgatitja e këtij raporti nuk do të ishte e mundshme pa bashkëpunimin e institucioneve të cilat në përgjithësi kanë ofruar qasjen në të dhënat e disponueshme me kohë, dhe vazhdimisht kanë qenë të hapura për konsultime dhe sqarime.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm dhe i pavarur që ka mandat për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e zgjedhjeve (Art. 115. i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme). Të gjithë qytetarët me të drejtë vote, subjektet politike, kandidatët dhe komisionerët e vendvotimeve kanë të drejtë të ankohen në faza të ndryshme të procesit zgjedhor nëse e vlerësojnë se ka pasur shkelje të ligjeve dhe rregullave zgjedhore apo të të drejtave të tyre.

Gjatë zgjedhjeve të mbajtura prej vitit 2009 deri 2019, numri i ankesave të dorëzuara në PZAP ka dalluar prej më së paku 326 në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 deri më së shumti në 1,117 në zgjedhjet lokale të vitit 2017 (Figura 1). Mesatarisht për zgjedhjet e mbajtura në nivel vendi gjatë viteve 2009 deri 2019, PZAP ka pranuar rreth 650 ankesa për zgjedhje.

Figura 1: Numri i ankesave dhe apeleve në zgjedhje, prej 2009 deri 2019



Ankesat janë shkelje të pretenduara të ligjeve zgjedhore. Apelet zakonisht përbëhen nga ankesa pas një vendimi të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (shih më poshtë)

Numri i ankesave është dukshëm më i lartë në zgjedhjet lokale se në zgjedhjet parlamentare. Kjo për shkak që në zgjedhje lokale çdo komunë konsiderohet si garë në vete dhe mund të kontestohet si e tillë, dhe numri i subjekteve politike dhe kandidatëve që garojnë është shumëfish më i lartë se në zgjedhjet parlamentare.

Numri i apeleve ndaj vendimeve të KQZ-së ka qenë relativisht i ulët. Me përjashtim të vitit 2019, figura e mësipërme nuk përfshijn apelet e dorëzuara nga votuesit jashtë vendit, ndaj vendimit të KQZ për refuzim të aplikacioneve të tyre për të votuar nga jashtë vendit (të cilat kontribuojnë në ngritjen e apeleve më lartë). Të dhënat përfshijnë vetëm apelet ndaj vendimeve të KQZ që: a) refuzojnë të certifikojnë subjektet politike apo listat e kandidatëve; b) refuzojnë të akreditojnë vëzhguesit; c) refuzojnë të regjistrojnë partinë; d) vendosin

gjoba administrative në lidhje me deklarimin e financave; apo e) ankesat tjera që ndërlidhen me procedurat e KQZ për zgjedhjet.

Periudha e fushatës, dita e zgjedhjeve dhe shpallja e rezultateve përfundimtare janë periudhat më të sfiduara të procesit zgjedhor. Periudha më pak të ngarkuara janë periudha e para-fushatës, heshtja zgjedhore dhe procedurat që zhvillohen pas ditës së zgjedhjeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (Figura 2).

Në zgjedhjet lokale 2013 dhe 2017 numri më i lartë i ankesave është shënuar në periudhën e shpalljes së rezultateve përfundimtare. PZAP mund të konsideroj planifikim të hershëm dhe vënje në disponueshmëri të të gjitha kapaciteteve për të u përballur me volumin e lartë të anksesave në këtë periudhë.

Figura 2: Numri i ankesave dhe apeleve, sipas fazave të procesit zgjedhor



Subjektet politike mund të dënohen me gjoba nëse vërtetohet që kanë shkelur ligjet dhe rregullat e zgjedhjeve. Gjatë zgjedhjeve prej vitit 2009 deri 2019 shuma totale e gjobave për zgjedhje ka dalluar prej më e ulëta 86,700 EUR në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, deri te më e larta 360,000 EUR në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 (Figura 3). Edhe pse pas vitit 2010 gjobat kanë qenë në trend të zbritjes dhe kanë arritur nivelin më të ulët në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, në tri zgjedhjet e fundit gjobat prap kanë shënuar trend të ngritjes.

Figura 3: Gjobat e PZAP-së për subjektet politike



Subjekti politik që është gjobitur me vlerën më të lartë është Partia Demokratike e Kosovës, e cila përveç zgjedhjeve lokale të vitit 2017, në të gjitha zgjedhjet ka qenë partia me ndëshkueshmërinë më të lartë. Lidhja Demokratike e Kosovës është subjekti politik i dytë me vlerën e gjobitjes më të lartë dhe në zgjedhjet lokale të vitit 2017 ka arritur vlerën më të lartë të ndëshkimit prej 78,550 EUR (Figura 4).

Figura 4: Gjobat e PZAP-së, sipas subjekteve politike[1]

	2009 lok.	2010 par.	2013 lok.	2014 par.	2017 par.	2017 lok.	2019 par.
PDK	85,620	148,400	93,150	55,900	158,000	34,950	100,100
LDK	48,900	88,050	38,100	12,200	71,700	78,550	74,850
AAK	12,720	77,600	36,300	3,900	-	17,200	89,600
VV	-	6,250	1,750	3,500	62,600	39,400	14,100
AKR	21,600	38,850	11,900	-	-	20,050	33,900
Tjera	41,330	18,300	9,350	11,200	56,600	67,200	47,450
Gjithsej (EUR)	**210,170**	**377,450**	**190,550**	**86,700**	**348,900**	**257,350**	**360,000**

[1] Në zgjedhjet parlamentare 2017, gjobat për AAK-në janë të përfshira në totalin e PDK-së, ndërsa të AKR-së në totalin e LDK-së. Në zgjedhjet 2019, gjoba e AAK-së përmbanë edhe të PSD-së, dhe gjobat e AKR-së përmbajnë edhe të NISMA.

Në bazë të Rregullorës mbi Kategoritë e Sanskioneve dhe Denimeve (01/2012). PZAP mund të sanksionoj etnitete politike në vlerë deri në 50.000 Euro. Tabela më lartë ngritë pyetjen se sa kanë qenë efektive masat e ndërmarra për zvogëlimin e shkeljeve elektorale nga partitë politike dhe kandidatët. Deri sa pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, ka një ulje të gjobave nga shuma totale, ndërsa pas zgjedhjeve të vitit 2014, shuma e gjobave nga shuma totale ka ngritje. PDK-ja, duke përjashtuar vetëm vitin 2017, ka vazhduar të jetë partia me më së shumti gjoba të shqiptuara. LDK është gjobitur me më shumë se 70.000 euro në secilën prej tri palë zgjedhjeve të fundit. Do të ishte intuitive të supozohej se pasi të gjobiteshin me shuma të tilla, subjektet politike do të bindeshin, mirëpo kjo nuk është dëshmuar të jetë e vërtetë.

Në vijim janë përmbledhur numri i ankesave sipas komunave ku kanë ndodhur shkeljet e pretenduara (Figura 5). Komunat me numrin më të lartë të votuesve prijnë me numrin më të madh të ankesave ku ka ndodhur shkelja e supozuar. Kjo mund të jetë për shkak që në këto komuna ka më shumë ngjarje të fushatës, më shumë vendvotime dhe më shumë votues. Në çdo palë zgjedhje, Prishtina, Prizreni dhe Ferizaji kanë qenë në top dhjetëshen e komunave ku ka pas shkelje të supozuara. Prej komunave me madhësi të mesme, Lipjani, Podujeva, Vushtria, dhe Malisheva janë komunat në të cilat ankesat kanë qenë të shpeshta. Përveç Komunave që udhëheqen nga komunitetet jo-shumicë ku numri i ankesave është dukshmërisht më i ulët, numri i ankesave ka qenë i ulët edhe në Komunat si Elez Han, Junik, Dragash dhe Deçan.

Figura 5: Numri i ankesave sipas komunave ku ka ndodhur shkelja e supozuar (të hijezuara, top 10 për secilën zgjedhje)

Komuna	2009 lok.	2010 par.	2013 lok.	2014 par.	2017 par.	2017 lok.
Prishtina	64	164	109	120	134	110
Lipjani	48	7	78	1	12	64
Obiliqi	5	2	46	1	7	65
Podujeva	21	6	31	24	11	44
F. Kosova	14	5	28	1	4	34
Drenasi	2	26	11	0	3	16
Graçanica	23	5	19	5	13	3
Peja	16	12	40	8	20	31
Istogu	12	4	57	5	4	39
Klina	7	11	45	1	4	21
Deçani	0	0	30	3	8	10
Mitrovica	7	32	36	10	16	51
Skenderaj	19	49	2	3	6	47
Vushtrri	9	12	101	2	1	66
Mitrovica V.	0	0	4	3	0	0
Zubin Potok	0	0	1	0	2	0
Leposaviçi	0	1	2	3	19	5
Zveçani	0	0	2	1	2	0
Gjilani	54	18	30	6	35	24
Kamenica	10	0	53	5	19	40
Vitia	11	2	35	2	5	14
Novo Brda	0	0	11	0	3	3
Kllokoti	0	0	1	1	0	37
Parteshi	14	0	4	0	0	3
Ranillug	0	0	2	0	0	1

Gjakova	26	8	36	3	13	57
Rahoveci	15	2	16	8	1	13
Malisheva	25	19	36	20	12	27
Junik	0	0	4	0	2	10
Prizren	58	28	81	48	22	128
Suhareka	31	3	17	11	8	10
Mamusha	0	0	6	3	2	4
Dragashi	2	5	2	0	0	0
Ferizaj	21	17	107	37	21	74
Shtime	12	0	12	1	5	40
Kaçanik	15	12	8	3	0	5
Hani i Elezit	4	0	5	0	0	6
Shtërpce	8	6	2	0	3	4

Lëvizja Vetëvendosje është ankuar në PZAP më shumë se subjektet e tjera politike. Në zgjedhjet parlamentare 2010 dhe 2014, VV ka qenë përgjegjëse për 36% të ankesave të pranuara nga PZAP. Partia Demokratike e Kosovës gjithashtu ka qenë konsistente me ankesa, duke dorëzuar 23% të ankesave totale në zgjedhjet lokale të vitit 2017. Prej organizatave të shoqërisë civile, Balkan Investigative Reporting Network (BIRN) ka mbajtur konsistencë duke dorëzuar ankesa në pothuajse çdo palë zgjedhje (Figura 6).

Figura 6: Kush ankohet më shumë

	2009 lok.	2010 par.	2013 lok.	2014 par.	2017 par.	2017 lok.
PDK	113	47	128	66	60	263
LDK	0	30	87	14	59	151
VV	-	177	157	124	71	160
AAK	30	15	41	2	0	106
NISMA	-	-	-	7	0	82

AKR	82	58	19	17	0	42
Kandidat	0	0	525	64	10	0
Lista Srpska	-	-	9	3	13	10
BIRN	0	39	27	2	37	128
Votues	59	50	9	7	0	76
OJQ dhe tjerë	266	76	107	35	171	117
Gjithsej	**550**	**492**	**1,109**	**341**	**421**	**1,135**

Gjithashtu, është me rëndësi të shikohet se çfarë ka ndodhur me ankesat pasi që janë trajtuar nga PZAP. Një përqindje e konsiderueshme e ankesave, prej 21% në zgjedhjet parlamentare 2014 deri në 37% në zgjedhjet lokale 2013, refuzohen për arsye procedurale. Arsyet procedurale mund të jenë ankesat që janë dorëzuar pas afatit kohor, që nuk posedojnë informatat e kërkuara (p.sh. emrin, nënshkrimin apo palën e pandehur), që nuk janë në kompetencë të PZAP-it, apo që tërhiqen nga ankesa. Duhet konsiderohet rishikimi i ligjeve për zgjedhje dhe rregulloreve të PZAP-së që të ju sigurohet mundësi ankuesit të korrigjojë çdo mangësi procedurale. Në çdo zgjedhje, përqindja më e lartë e ankesave refuzohen si të pabazuara. Përqindja e ankesave të miratuara në përgjithësi ka qenë më e lartë në zgjedhjet parlamentare se sa në zgjedhjet lokale dhe ka arritur rreth 40% në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 dhe 2019 (Figura 7).

Figura 7: Numri i vendimeve të PZAP, sipas llojeve të vendimeve[1]



Në zgjedhjet e kaluara rreth 3% deri 5% e vendimeve të PZAP janë apeluar në Gjykatën Supreme. Numri i vendimeve të PZAP-së të apeluara në Gjykatën Supreme është dukshëm më i lartë në zgjedhjet lokale se sa në zgjedhjet parlamentare (Figura 8). Kjo është për shkak të numrit të lartë të ankesave, dhe numrit edhe më të lartë të kandidatëve që garojnë në zgjedhjet lokale.

Figura 8: Numri i vendimeve të PZAP-së të apeluara në Gjykatën Supreme, sipas llojit të vendimit të Gjykatës

	2009	2010	2013	2014	2017	2017

[1] Për zgjedhjet lokale të vitit 2009 nuk dihet nëse ankesat e refuzuara për arsye procedurale janë vendosur brenda numrit të ankesave të pabazuara.

	lok.	par.	lok.	par.	par.	lok.
Apele në Gjykatën Supreme	25	19	48	16	11	47
Apele të miratuara	0	1	1	2	3	7
Apele të refuzuara	25	18	47	14	8	40

Përderisa në zgjedhjet e mbajtura prej vitit 2009 deri në 2013 Gjykata Supreme ka refuzuar si të pabazuara më shumë se 95% të rasteve, prej zgjedhjeve të vitit 2014 e tutje përqindja e apeleve të miratuara ka shënuar ngritje. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 dhe lokale të vitit 2017, Gjykata Supreme ka miratuar 27% dhe 15% të apeleve, respektivisht.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve. KQZ kontribuon në vendosjen e drejtësisë në zgjedhje duke ndërmarrë veprime si: referimi i rasteve penale tek organet e drejtësisë, ofrimi të ekspertizës në zgjidhjen e lëndëve, mbikqyrja e financave të subjekteve politike, shqyrtimi dhe verifikimi i aplikacioneve të votimit nga jashtë, dhe diskrecioni për përsëritje të votimit apo rinumërim të vendvotimeve.

Sa i përket votimit nga jashtë Kosovës, Komisioni Qendror Zgjedhor administron pranimin dhe verifikimin e aplikacioneve të votuesve nga jashtë, dhe bën vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës. Vendimet e KQZ-së për miratim ose refuzim të aplikacioneve të votuesve nga jashtë mund të apelohen në PZAP.

Pas zgjedhjeve të vitit 2009 dhe 2010, numri i aplikacioneve për votim nga jashtë vendit është ngritur në mënyrë drastike në zgjedhjet lokale të vitit 2013 duke e arritur kulmin e 41,168 aplikacioneve (Figura 9). Kjo rritje e panatyrshme ishte kryesisht për shkak të grumbullimit dhe fasilitimit të organizuar të aplikacioneve për votuesit nga Republika e Serbisë.

Figura 9: Shqyrtimi i aplikacioneve për Votim nga Jashtë nga KQZ

	2009 lok.	2010 par.	2013 lok.	2014 par.	2017 par.	2017 lok.	2019 par.
Aplikacione të pranuara	1,806	5,015	41,168	29,745	20,354	11,815	35,087
Aplikacione të aprovuara	-	1,640	13,653	16,569	15,118	10,487	29,861
Përqindja e aprovuar	-	32%	33%	55%	74%	89%	85%

Pas këtyre zgjedhjeve u shënua një ulje e numrit të aplikacioneve në zgjedhjet e mbajtura në vitet 2014 dhe 2017, dhe një ri-ngritje në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019. Përgjatë viteve, përqindja e aplikacioneve të aprovuara është ngritur në mënyrë të dukshme. Kjo mund të jetë edhe për shkak të përkrahjes që subjektet politike u ofrojnë votuesve jashtë vendit gjatë procesit të aplikimit, dhe fushatave mobilizuese që organizohen nga subjektet politike jashtë vendit. D4D nuk ka arritur të siguroj të dhënat për numrin e apeleve ndaj vendimeve të KQZ-së të dorëzuara në PZAP për aprovim apo refuzim të aplikimit për votim nga jashtë, dhe më pas numrin e apeleve të refuzuara apo miratuara nga PZAP.

Në periudhën 2009-2014, ka pasur raste ku janë përsëritur zgjedhjet në ndonjë komunë në të gjitha vendvotimet, mirëpo ka pasur raste edhe kur janë përsëritur në mënyrë të pjesshme, që do të thotë në një apo disa vendvotime të caktuara. Përsëritja e zgjedhjeve u urdhërua në bazë të vendimeve të PZAP, KQZ apo Gjykatës Supreme, për arsye të ndryshme si: mbushja e kutive në mënyrë të pa-rregullt, vjedhja e votave, mospërputhja e rezultateve, dhuna apo presioni.

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009, u urdhërua përsëritja e plotë e zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit në komunën e Lipjanit, Prizrenit dhe Gjilanit. Ne vitin 2010 zgjedhjet u përsëritën në të gjitha qendrat e votimit në komunën e Deçanit, Skenderajt, Drenasit dhe Mitrovicës, dhe pjesërisht në nga një qendër të votimit në Malishevë dhe Lipjan. Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013, zgjedhjet u përsëritën në një qendër të votimit në Partesh, dy qendra të votimit në Zveçan dhe tri qendra të votimit në Mitrovicën e Veriut. Në zgjedhjet lokale të vitit 2017, zgjedhjet janë përsëritur në Istog dhe Partesh.

Megjithatë përsëritja e zgjedhjeve është duke u bërë praktikë më e pazakonshme, veçanërisht për zgjedhjet parlamentare për të cilat nuk ka pas asnjë përsëritje në tri pale zgjedhjet e

fundit parlamentare të, 2014, 2017 dhe 2019. Janë një numër i faktorëve që mund të kenë ndikuar në këtë: ulja e mashtrimeve zgjedhore, koordinimi i përmirësuar mes institucioneve të drejtësisë zgjedhore dhe organeve të menaxhimit të zgjedhjeve, si dhe integrimi më i mirë i komunitetit serb në zgjedhje. Ndërsa në zgjedhjet e fundit lokale 2017 dhe zgjedhjet parlamentare 2019, është shënuar ngritje të konsiderueshme të vendvotimeve të rinumëruara (Figura 10).

Figura 10: Përsëritjet e zgjedhjeve dhe rinumërimi në zgjedhjet prej 2009 deri 2019

	Nr.i komunave ku janë përsëritur zgjedhjet	Nr. i vendvotimeve të rinumëruara
2009 lok.	3 komplet	450
2010 par.	4 komplet | 2 pjesërisht	890
2013 lok.	3 pjesërisht	439
2014 par.	Asnjë	421
2017 par.	Asnjë	565
2017 lok.	2 komplet	1,130
2019 par.	Asnjë	2,247

Sa i përket financave të subjekteve politike, për zgjedhjet lokale të vitit 2013 KQZ ka gjobitur dhjetë subjekte politike për vonesë në dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore, ndërsa pas zgjedhjeve lokale 2017 janë gjobitur edhe tri subjekte tjera për të njëjtën arsye. Shumica e këtyre subjekteve nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, dhe nuk kanë qasje në financat publike që ju ndahen subjekteve të përfaqësuara, e që nënkupton se mund të mos kenë kapacitetet e nevojshme administrative për përgatitjen e raporteve financiare. Asnjë subjekt politik nuk ka vonuar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet parlamentare, dhe si rezultat nuk ka pas gjoba në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, 2017 dhe 2019 (Figura 11).

Figura 11: Gjobat e KQZ për subjektet që kanë vonuar dorëzimin e raporteve financiare të fushatës

Subjekti Politik	Vonesa	Gjoba
Zgjedhjet lokale 2013		
Partia e Ashkalinjeve për Integrim	47 ditë	€ 3.516
Kosova Turk Adalet Partisi	34 ditë	€ 1.003
Crnogorska Liberalna Stranka	32 ditë	€ 1.002
Inicijativa za Bolji Život	81 ditë	€ 1.008
Zajedno za Lipljan	81 ditë	€ 1.008
Hysni Rexhepi	81 ditë	€ 1.008
Demokratska Inicijativa	78 ditë	€ 1.008
Narodna Pravda	77 ditë	€ 1.008
Partia Socialdemokrate	71 ditë	€ 1.007
Ylli Isufi	84 ditë	€ 1.008
GJITHSEJ 2013 lokale		**€ 12.578**
Zgjedhjet parlamentare 2014		
	0	0
Zgjedhjet parlamentare 2017		
	0	0
Zgjedhjet lokale 2017		
PSHDK	92 ditë	€ 1,009.20
Gi Narodna Pravda	14 ditë	€ 1,001.40
Gi Narodno Jedinstvo	46 ditë	€ 1.004,60
TOTAL 2017 lokale		€ 3,015.20
Zgjedhjet parlamentare 2019		
	0	0

Prokuroria Shtetërore

Prokuroria Shtetërore (PSH) është përgjegjëse për ndjekjen penale të personave që kanë kryer veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit ka rënë në mënyrë drastike. Kjo mund të jetë për arsye të ndryshme: dukshmëria më e lartë e autoriteteve gjyqësore në luftimin e keqpërdorimeve zgjedhore, sanksionet kuptimplota ndaj shkelësve të ligjit, dhe ulja e veprave penale të kryera nga partitë politike. Në vitin 2013 numri i kallëzimeve penale ishte 209 duke përfshirë 1,216 persona, ndërsa deri në Shtator të vitit 2019, Prokuroria Shtetërore i ka pas në punë vetëm 69 kallëzime penale që përfshijnë 109 persona (Figura 12).

Figura 12: Numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë, nga viti 2013 deri në Shtator 2019



Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe parlamentare të vitit 2014, numri i lëndëve të reja të pranuara është ngritur. Në vitin 2014 numri i lëndëve të reja ishte 169, ndërsa në vitin 2015 janë pranuar 234 lëndë të reja, që së bashku me kallëzimet penale nga vitet paraprake kanë ngritur numrin e kallëzimeve penale në gjithsejtë 433 gjatë vitit 2015.

Pas këtyre zgjedhjeve, numri i kallëzimeve të reja penale ka rënë në mënyrë drastike. Edhe pse u mbajtën zgjedhjet lokale dhe parlamentare në vitin 2017, numri i kallëzimeve penale të reja të pranuara gjatë vitit 2017 ka qenë 5, gjatë vitit 2018 ka qenë 11, ndërsa deri në Shtator të vitit 2019 ka qenë vetëm 2 (Figura 13).

Figura 13: Numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë, nga viti 2013 deri në Shtator 2019.

Viti 2013	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	90	562
Të reja të pranuara gjatë vitit	119	654
Total kallëzime penale 2013	**209**	**1,216**
Të zgjidhura	104	577
Të pazgjidhura	105	639

Viti 2014	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	105	639
Të reja të pranuara gjatë vitit	169	244
Total kallëzime penale 2014	**274**	**883**
Të zgjidhura	75	229
Të pazgjidhura	199	654

Viti 2015	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	199	640
Të reja të pranuara gjatë vitit	234	247
Total kallëzime penale 2015	**433**	**887**

Të zgjidhura	233	535
Të pazgjidhura	200	352

Viti 2016	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	200	352
Të reja të pranuara gjatë vitit	1	1
Total kallëzime penale 2016	**201**	**353**
Të zgjidhura	24	42
Të pazgjidhura	177	311

Viti 2017	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	177	311
Të reja të pranuara gjatë vitit	5	50
Total kallëzime penale 2017	**182**	**361**
Të zgjidhura	66	201
Të pazgjidhura	116	160

Viti 2018	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	116	160
Të reja të pranuara gjatë vitit	11	13
Total kallëzime penale 2018	**127**	**173**
Të zgjidhura	60	66
Të pazgjidhura	67	107

Janar - Shtator 2019	**Kallëzime**	**Persona**
Të mbetura nga viti paraprak	67	107
Të reja të pranuara gjatë vitit	2	2
Total kallëzime penale 2019	**69**	**109**
Të zgjidhura	24	30
Të pazgjidhura	45	79

Në shumicën e rasteve kallëzimet penale dorëzohen nga policia e Kosovës. Gjatë vitit 2014 dhe 2015, Policia e Kosovës ishte përgjegjëse për 56% dhe 75%, respektivisht, të kallëzimeve penale të parashtruara. Një pjesë e konsiderueshme e kallëzimeve penale parashtrohen nga subjekte të tjera, e këtu mund të jenë përfshirë edhe trupat menaxhuese të zgjedhjeve. Numri i kallëzimeve penale të ngritura direkt nga qytetarët dhe prokuroria ndër vite ka qenë shumë i ulët ose zero (Figura 14). Qytetarët mund të kenë mungesë të informatava se ata mund të ngrisin padi penale për shkelje të ligjeve zgjedhore ose të drejtave tyre zgjedhore.

Figura 14: Numri i kallëzimeve penale të dorëzuara në vitin 2013 dhe 2019, sipas parashtruesve

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	09. 2019
Qytetarët	0	2	0	0	0	0	0
PK	30	95	177	0	0	0	2
AKK	0	1	0	0	0	0	0
Inspektorati	62	44	0	0	5	0	0
EULEX	0	0	0	0	0	0	0
Tjerë	27	27	56	1	0	11	0
Prokuroria	0	0	1	0	0	0	0
GJITHSEJ	**119**	**169**	**234**	**1**	**5**	**11**	**2**

Policia e Kosovës

Policia e Kosovës (PK) është kryesisht përgjegjëse për të mbajtur rendin dhe sigurinë në proceset zgjedhore.

Gjatë fushatës në zgjedhjet e vitit 2013, PK ka hapur 37 lëndë të shkeljeve zgjedhore. Nuk ka detaje mbi llojin apo natyrën e shkeljeve, por kjo mund të përfshijë raste kur polica ka qenë dëshimtar i shkeljeve gjatë ngjarjeve politike, dhe ka shoqëruar personat e përfshirë në PK për marrje në pyetje. Më shumë se një e treta (41%) e lëndëve janë referuar në PSH për hetime të mëtejshme. Në zgjedhjet e vitit 2014, ka pasur shumë më pak lëndë të hapura.

